



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



16.04.2013			
№ i organit	№ i organit	Shitja	Vlera
Org. broj	KOMUN/BROJ	Prilog	Vite
01-013/325			

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit nr. 03/L-164, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 12.04.2013, aprovon këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E BANESAVE PËR PROGRAME TË VEÇANTA TË BANIMIT

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Vendimin për ndarjen e **25 (njëzetë e pesë)** banesave nga programi i banesave me qira joprotabile të subvencionuara nga Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për rastet e pa strehë si dhe veteranët e luftës dhe atë:

- 20 (njëzetë) banesa për rastet të pa strehë;
- 4 (katër) banesa për veteranët e luftës;
- 1 (një) banesë për minoritete.

Neni 2

Pas aprovimit të këtij vendimi nga Kuvendi Komunal, obligohet Kryetari i Komunës së Vitisë që ta formoj Komisionin për vlerësimin dhe përzgjedhjen- ndarjen e banesave i cili do të punojë dhe veproj në bazë të Ligjit për Financimin e programeve të veçanta të banimit si dhe Udhëzimeve në fuqi në bazë të kritereve të parapara për ndarjen e banesave për kategoritë e tilla.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Kryetarit të Komunës,
2. Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi